



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201502424/5

Tiranë ___/___/2016

Lënda : *Rekomandim për nxitjen dhe shpejtimin e procedurës së miratimit të disa akteve nënligjore në bazë e në zbatim të neneve 73/2; 68; 81/2; 75; 67/c; 63; 69 70/2; 67/2 të Ligjit nr. 108/2014 "Për Policinë e Shtetit",*

Drejtuar : Drejtorit të Policisë së Shtetit
Z. Haki ÇAKO

Për dijeni : Ministrit të Punëve të Brendshme
Z. Saimir TAHIRI

Tiranë

I nderuar zoti Çako,

Me shkresën nr. K2/S56-2 Prot., datë 25.11.2015 ju kemi vënë në dijeni lidhur me ankesën e bërë në Institucionin e Avokatit të Popullit nga Sindikata e Punonjësve të Policisë së Shtetit. Sipas Sindikatës, ligji i ri nr. 108/2014 "Për Policinë e Shtetit" ka hyrë në fuqi në datën 01.03.2015. Në nenin 143 të tij është parashikuar nxjerrja nga Këshilli i Ministrave dhe Ministri i Punëve të Brendshme e disa akteve nënligjore brenda 6 muajve nga botimi i ligjit në Fletoren Zyrtare. Ndonëse ligji është botuar në Fletoren Zyrtare në datën 01.09.2014, pra ka kaluar afati ligjor prej 6 muaj, nga Këshilli i Ministrave dhe Ministri i Punëve të Brendshme nuk janë nxjerrë disa prej këtyre akteve nënligjore dhe konkretisht ato në zbatim të neneve 61, pika 1; 62; 63, pika 6; 64, pika 3; 67, pika 2; 68, pika 4; 69, pika 3; 70, pika 2; 71; 72, pika 2; 75, pika 1 shkronja "ç", dhe pika 2; 81, pika 2.

Sindikata pretendon se, për shkak të mosnxjerrjes së këtyre akteve nënligjore, punonjësve të Policisë së Shtetit iu janë mohuar disa të drejta dhe përfitime materiale e financiare që nga data 01.03.2015. Këto të drejta e përfitime lidhen me; përcaktimin e funksioneve për gradë, kohën e punës e të pushimit, kujdesin për gratë shtatzanë, trajtimin financiar gjatë qëndrimit në punë, të drejtën e sigurimit shëndetësor të veçantë, të drejtën për të përfituar kredi, të drejtën për kompensim për strehimin, sigurimin e jetës në rast aksidenti

në detyrë ose për shkak të detyrës, mbrojtjen e veçantë, trajtimin financiar pas ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, trajtimin e familjarëve të punonjësve që humbin jetën për shkak të detyrës, bashkëpunimin me të tretët.

Në bazë të kërkesës tonë, ju me shkresën nr. 7386/ 1 Prot., datë 07.12.2015 na informuat se, me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, nr. 1433/1, datë 02.10.2014, është vendosur ngritja e grupeve të punës për përgatitjen e projektakteve nënligjore në zbatim të Ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”.

Nga grupet e punës në zbatim të këtij urdhri, janë përgatitur projektaktet respektive. Disa nga këto projektakte janë miratuar, ndërsa disa të tjera janë në procedurë miratimi.

Në vijim të kësaj shkrese ju na informuat se, janë miratur 4 akte nënligjore dhe janë dërguar për procedurë të mëtejshme miratimi 10 projektakte të tjera në zbatim të neneve 73/2; 68; 81/2;75; 67/c; 63; 69 70/2; 67/2 të Ligjit nr. 108/2014.

Ndërsa përsa i përket projektvendimeve të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e funksioneve korresponduese për gradat në Policinë e Shtetit” dhe “Për pagat e punonjësve të Policisë së Shtetit”, përgatitja e këtyre është e determinuar nga miratimi i strukturës organike të Policisë së Shtetit.

Me miratimin e strukturës organike të Policisë së Shtetit nga Ministri i Punëve të Brendshme, që do të realizohet në muajin dhjetor 2015, njëkohësisht do të draftohen edhe dy projektaktet e sipërcituara.

Pas shqyrtimit të kësaj ankese dhe të përgjigjes së dërguar nga ana juaj konstatojmë se, pretendimi i ngritur nga Sindikata e Punonjësve të Policisë së Shtetit është i drejtë. Aktet nënligjore në bazë e në zbatim të Ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” nuk janë përgatitur dhe miratuar brenda afatit të parashikuar nga ky ligj, duke përfshirë edhe 4 aktet të cilat tashmë janë miratuar. Mosmiratimi i këtyre akteve në kohë ka sjellë si pasojë moszbatimin e plotë të këtij ligji dhe për rrjedhojë cënimin e disa të drejtave ligjore të punonjësve të Policisë së Shtetit.

Pa i hyrë problemit të shkaqeve që kanë sjellë këtë zvarritje për miratimin në kohë të këtyre akteve, me atributet e Institucionit Kushtetues që ka si objekt të punës së tij, mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të ligjshëm të qytetarëve nga organet e administratës publike, pjesë e të cilës janë edhe punonjësit Policisë së Shtetit, jemi të interesuar që të respektohen në kohë të gjitha të drejtat ligjore të këtyre të fundit, të cilat ua jep ligji.

Për sa më sipër dhe me qëllim rivendosjen në vend të të drejtave të mohuara punonjësve të Policisë së Shtetit, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku thuhet se: “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike*” dhe në nenin 21 të Ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, i ndryshuar, respektivisht në shkronjën “b” ku parashikohet se: “*Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive*”,

REKOMANDOJMË:

1. Përgatitjen sa më shpejtë të projektvendimeve të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e funksioneve korresponduese për gradat në Policinë e Shtetit” dhe “Për pagat e punonjësve të Policisë së Shtetit”.

2. Marrjen e masave të nevojshme duke i kërkuar organeve përkatëse miratimin sa më shpejtë të të gjitha projektakteve nënligjore në zbatim të neneve 73/2; 68; 81/2;75; 67/c; 63; 69 70/2; 67/2 të Ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, lutemi të na ktheni përgjigje brenda afatit ligjor prej 30 ditësh të parashikuar në nenin 22 të Ligjit “Për Avokatin e Popullit”.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

AVOKATI I POPULLIT

Igli TOTOZANI

Në mungesë e porosi

K O M I S I O N E R I

Arben SHKËMBI